



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202300703/16

Tiranë ___/___/2023

Lënda: *Rekomandim për sigurimin e shumëllojshmërisë ushqimore për të burgosurit sipas kërkesave ligjore dhe normës ushqimore të miratuar për këtë kategori në Udhëzimin e përbashkët Nr.1, datë 22.02.2022 "Për miratimin e normës ushqimore ditore për të burgosurit".*

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BURGJEVE

Drejtorit të Përgjithshëm

Z. Admir Abrija

Tiranë

I nderuar Z. Abrija,

Në letërkëmbimin e mëparshëm që kemi patur, jeni njohur me ankesën e paraqitur nga i burgosuri S. P., aktualisht i transferuar në IEVP Korçë i cili pretendonte se kur vuante dënimin në IEVP Burrel, gjatë gjithë vitit i është shërbyer si ushqim vetëm makarona, oriz dhe fasule dhe nuk i është dhënë për të konsumuar produkte të bagëtive si qumësht, kos dhe djath. Në vend të tyre i është dhënë qumësht soje dhe tofu. Gjithashtu, ky i burgosur pretendonte se në ushqim ishin hedhur doza të larta të sodës së bukës.

Për verifikimin e kësaj ankese, fillimisht i jemi drejtuar me shkresë për shpjegime IEVP Burrel, e cila na ka kthyer përgjigje me shkresën Nr.2758/1 Prot., datë 07.09.2023 ku thuhet se: përgatitja e menusë ditore bëhet në bazë të artikujve, me të cilat furnizohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, sipas normës së përcaktuar në shkresën Nr. 1126/3 Prot., datë 03.04.2022, të Ministrisë së Drejtësisë. IEVP Burrel rrëzon pretendimet e të burgosurit S. P. dhe si dëshmi e ushqimit të shpërndarë për të burgosurit, na ka vënë në dispozicion menunë e ushqimit për periudhën Korrik – Gusht 2023¹ dhe pasqyrën e normës së ushqimit për muajt Janar dhe Maj 2023. Gjithashtu, IEVP Burrel shprehet se soda e bukës nuk përdoret në këtë institucion.

Referuar përshkrimit të menusë së ushqimit, për periudhën Korrik – Gusht 2023, rezulton sa vijon:

- Perimet e gatuar janë vetëm: bizele, patate dhe kungull;
- Kosi dhe thjerëzat nuk janë siguruar nga IEVP Burrel, pavarësisht se këto dy produkte parashikohen në Udhëzimin e përbashkët Nr.1, datë 22.02.2022 “*Për miratimin e normës ushqimore ditore për të burgosurit*”, të nënshkruar nga Ministri i Drejtësisë dhe Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale². Për më tepër, në normativën e miratuar parashikohet se produkti fasule i përdorur në dimër, zëvendësohet me të njëjtën normë ditore e shprehur në gramë, me thjerrëza në verë.
- Nuk specifikohet lloji i mishit që është përdorur dhe lloji i frutit/frutave që iu është shpërndarë të burgosurve.

Për sa i përket verifikimit të pretendimit të të burgosurit, se në ushqim ishin hedhur doza të larta të sodës së bukës dhe se në vend të produkteve të bagëtive, të

¹ Nga ana jonë është kërkuar informacion për të gjithë vitin e fundit kur i burgosuri Sokol Përmarkaj ka qëndruar në IEVP Burrel. Sipas shpjegimeve të këtij të burgosuri, ai ka vuajtur dënimin në IEVP Burrel në periudhën 15.06.2015 – 06.07.2023.

² Ky Udhëzim është protokolluar në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me Nr.995/1 Prot., datë 07.03.2022 dhe në Ministrinë e Drejtësisë me Nr.1126 Prot., datë 22.02.2022.

burgosurve u është dhënë qumësht soje dhe tofu, i jemi drejtuar me shkresë për kompetencë Drejtorisë Rajonale të Kontrollit Ushqimor Dibër dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit Ushqimor, ku kemi kërkuar të ushtrohet kontroll nëse hidhet sodë buke në ushqimin që ofron IEVP Burrel, sa është doza e këtij produkti dhe nëse qumështi dhe nënproduktet e tij që konsumohen nga të burgosurit, vijnë nga bagëtitë apo nga ndonjë produkt tjetër.

Në përgjigjen që kemi marrë nga Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit Ushqimor me shkresën nr.5712/1 Prot., datë 16.11.2023, jemi vënë në dijeni se: Drejtoria Rajonale Dibër ka kryer inspektim në IEVP Burrel në datën 31.11.2023, ku nga kontrolli i ushtruar, për sa i përket pretendimit të të burgosurit, ka rezultuar se në mjediset e kuzhinës dhe në magazinë nuk gjendet sodë buke (bikarbonat natriumi). Edhe në kontratën që disponohet me operatorin e biznesit ushqimor, për produktet ushqimore nuk është i përfshirë ky produkt. Ndërsa, qumështi i përdorur, i furnizuar nga kontraktuesi, është qumësht lope i pasterizuar, me paketim një litrosh.

Ndërsa, për sa i përket verifikimit të pretendimit që ka bërë me shumëllojshmërinë e ushqimit që i ofrohet të burgosurve, iu drejtuam institucionit tuaj me shkresën Nr. K2/S17-5 Prot., datë 15.09.2023, ku kërkuam të informohemi për sa më poshtë vijon:

- Me çfarë lloj perimesh, frutash dhe mishi është furnizuar IEVP Burrel në periudhën 2022-2023.
- Nëse IEVP Burrel dhe IEVP-të e tjera nuk janë furnizuar me artikujt ushqimorë thjerrëza dhe kos, cila ka qenë arsyeja.
- Nëse qumështi dhe nënproduktet e tij, me të cilat furnizohen IEVP-të vijnë nga bagëtitë apo nga ndonjë produkt tjetër.

Në përgjigjen që kemi marrë me shkresën tuaj Nr. 11996/1 Prot., datë 07.11.2023 thuhet për sa më poshtë vijon:

“Referuar llojshmërisë së perimeve e frutave si dhe llojit të mishit që Institucioni i Ekzekutimeve Penale Burrel është furnizuar në periudhën 2022-2023, evidentohet se ky institucion ashtu si të gjitha IEVP-të e sistemit të burgjeve është furnizuar me mish viçi sipas kontratave të nënshkruara me Operatorët Ekonomikë konform specifikimeve teknike, të cilat janë pjesë përbërëse të kontratave. Gjatë marrjes në dorëzim, çdo komision i pritjes së mallit, përveç se verifikon mallin, e pranon atë të shoqëruar me certifikatë veterinare.

Evidentohet se IEVP Burrel është furnizuar me artikuj perime (patate, qepë, domate, presh, karrota, lakër, spinaq, patllëxhan, specia, bizele të ngrira) dhe fruta (mollë, portokalle, pjeshkë).

Në lidhje me furnizimin e IEVP Burrel dhe IEVP-ve të tjera me artikullin “Kos”, ju informojmë se për të gjithë shtetasit e dënuar, pjesë e normës ushqimore është artikulli qumësht. Artikulli “Kos” është pjesë e normës ushqimore për shtetasit e dënuar, të cilat janë të sëmurë diabetikë. Dieta e të dënuarve diabetikë duhet të trajtohet sipas rekomandimeve të mjekut. Si i tillë, artikulli “Kos” është pjesë e kontratës së lidhur me objekt “Blerje bulmet dhe nënproduktet e tij”.

Për sa i takon furnizimit të IEVP Burrel dhe IEVP-ve të tjera me artikullin “Thjerrëza”, kontrata për këtë artikull është firmosur me operatorët ekonomikë në muajin Gusht 2023. Sikurse IEVP-të e tjera, ashtu edhe IEVP Burrel është furnizuar me 250 kg thjerrëza, me të cilat ka alternuar artikullin “fasule”.

Ju informojmë që qumështi dhe nënproduktet e tij, me të cilat furnizohen IEVP-të, vijnë nga bagëtitë. Duke iu referuar kontratës së nënshkruar me operatorët ekonomikë me objekt “Blerje bulmet dhe nënprodukte të tij”, theksojmë se artikujt “Qumësht”, “Djathë”, “Kos” dhe “Gjalp” janë sipas specifikimeve teknike:

- 1. Artikulli “Qumësht” – Qumësht me yndyrë të plotë i pasterizuar. Treguesit cilësor edhe fiziko-kimikë janë sipas standardit shtetëror.*
- 2. Artikulli “Djathë” – Lloji djathë fetë lope, dhie ose dele, cilësi e parë.*

3. Artikulli “Gjalp” – Klasifikimi gjalpë pa kripë, lloji gjalp lope i freskët, cilësi e parë.
4. Artikulli “Kos” – Klasifikimi kos lope, cilësi e parë.

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, bazuar në specifikimet teknike të artikujve ushqimorë informon se qumështi dhe nënproduktet e tij, me të cilat furnizohen IEVP-të, vijnë nga bagëtitë”.

Meqenëse në Udhëzimin e përbashkët Nr.1, datë 22.02.2022 “Për miratimin e normës ushqimore ditore për të burgosurit”, nuk specifikohet nëse artikulli “Kos” përfshihet në normën e të burgosurve të sëmurë, iu drejtua Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për të na informuar nëse ky artikull, është përfshirë si artikull vetëm për të burgosurit e sëmurë diabetikë apo edhe për të burgosurit e tjerë, për të shtuar shumëllojshmërinë e ushqimit.

Në përgjigjen që kemi marrë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me shkresën Nr. 4187/1 Prot., datë 22.11.2023 informohemi se: “Udhëzimi i përbashkët Nr.1, datë 22.02.2022 “Për miratimin e normës ushqimore ditore për të burgosurit”, i Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale përcakton normat ushqimore për 4 kategori të të burgosurve, konkretisht për të burgosurit jo të punësuar, për të burgosurit e punësuar, për të burgosurit e mitur jo të punësuar dhe për të burgosurit e mitur të punësuar. Në normat ushqimore për të gjitha këto kategori është përfshirë artikulli “qumësht/kos” me normat ditore, vlerat energjike dhe përmbajtjen e proteinave, yndyrnave dhe glucideve”.

Sipas kuadrit ligjor që rregullon trajtimin ushqimor të të burgosurve, në pikën 4 të nenit 36 të Ligjit Nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, parashikohet se: “Ushqimi i siguruar nga institucioni duhet të jetë i shumëllojshëm, i pasur me vlera ushqyese, të ndryshohet të paktën një herë në dy javë dhe t’u përshtatet kushteve klimaterike”.

Referuar dokumentacionit që na është vënë në dispozicion nga IEVP Burrel, përgjigjes që kemi marrë nga institucioni juaj dhe përgjigjes që kemi marrë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, rezulton se të burgosurve nuk u është siguruar ushqim i shumëllojshëm, më konkretisht:

- Nuk është ndryshuar menuja një herë në dy javë;
- Nuk është siguruar gatimi me thjerrëza në kohën e duhur;
- Nuk është siguruar produkti “Kos” për të gjithë të burgosurit, sipas Udhëzimit të përbashkët Nr.1, datë 22.02.2022 “*Për miratimin e normës ushqimore ditore për të burgosurit*”;
- Nuk është siguruar në nivel të pritshëm shumëllojshmëri frutash dhe zarzavatesh sipas stinës;
- Nuk është siguruar mish pule, përveç mishit të viçit.

Ankesa për mungesë të shumëllojshmërisë së ushqimit që u sigurohet të burgosurve, janë evidentuar në disa IEVP, edhe nga Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, gjatë inspektimeve që ka kryer në vitin 2023.

Avokati i Popullit ka vënë theksin në mënyrë të vazhdueshme se rishikimi i menisë ushqimore ka qenë domosdoshmëri për shumë vite dhe se edhe udhëzimi i vitit 2022 nuk ka sjellë përmirësimin e nevojshëm e të domosdoshëm për të siguruar jetesë të denjë në sistemin penitenciar. Pavarësisht përpjekjeve në këtë drejtim ka vend për të përmirësuar shumëllojshmërinë në përgjithësi dhe cilësinë në disa raste, për ushqimin që iu ofrohet të burgosurve.

Për sa më lart, bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut*” si dhe në mbështetje të nenit 21/b të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 “*Për Avokatin e Popullit*” i ndryshuar ku përcaktohet se: “*Avokati i Popullit paraqet rekomandime*

për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”.

REKOMANDOJMË:

- Marrjen e masave të nevojshme për përmirësimin e punës për garantimin e shumëllojshmërisë ushqimore për të burgosurit sipas kërkesave ligjore dhe normës ushqimore të miratuar për këtë kategori në Udhëzimin e përbashkët Nr.1, datë 22.02.2022 “*Për miratimin e normës ushqimore ditore për të burgosurit*”.
- Marrjen e masave për të bërë një studim për të evidentuar nevojat për përmirësimin e shumëllojshmërisë ushqimore në mënyrë efektive në sistemin penitenciar.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, na vini në dijeni brenda afatit ligjor 30 ditor, të parashikuar në nenin 22 të Ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “*Për Avokatin e Popullit*”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Ermonela Ruspi